REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJË

Nr._____prot. Kavajë, më___.___.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë_____. _____ 2026

Për ndryshimin e emërtimit të kopshtit "Fiqiri Kurti + Mehmet Babamusta" dhe emërtimin e këtij kopshti në "KOPSHTI DIELL"

Në mbështetje të nenit 8, 9, 54, 55, 66 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Ligjit Nr.9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" të ndryshuar, të Ligjit Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Ligjin nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbështetur në kërkesën e paraqitur nga Bordi i Institucionit, stafi edukativ dhe prindërit e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin në fjalë, **i propozohet** Këshillit Bashkiak Kavajë që në mbledhjen e tij të radhës,

TË VENDOSË:

1. Ndryshimin e emrit të kopshtit "Fiqiri Kurti", lagja nr.3 Bashkia Kavajë dhe emërtimin e këtij kopshti me emrin "Kopshti Diell".
2. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet, Drejtoria e Shërbimeve Publike si dhe Agjencia e Arsimit Parashkollor dhe e Shërbimeve Mbështetëse të Aresimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendra Kulturore.
3. Në rast miratimi të këtij projekti, ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike për vendosjen e tabelave të emërtimeve të objekteve arsimore.
4. Ky projekt-vendim, pas miratimit, hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Sekretari i Përgjithshëm
Adrian MALAJ

Drejtoria Ligjore
Helidon PLAKU

Drejtoria e Shërbimeve Publike
Mario Kola

Agjencia e Arsimit Parashkollor,
Parauniversitar dhe Qendra Kulturore
Edmond ÇURUMI

Sekretare e Këshillit Bashkiak
Meri BITURKU

K R Y E T A R I
FISNIK QOSJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJË

Nr._____prot. Kavajë, më___.___.2026

PROJEKT-PROPOZIM

PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË INSTITUCIONIT PARASHKOLLOR "NGA KOPSHTI FIQIRI KURTI + MEHMET BABAMUSTA" NË "KOPSHTI DIELL"

Bazuar në kërkesën e paraqitur nga Bordi i kopshtit **"Fiqiri Kurti"+ "Mehmet Babamusta"**, drejtoria e kopshtit, stafi edukativ dhe prindërit e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin **"Fiqiri Kurti"**, Drejtoria Arsimit Parashkollor Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore i propozon Këshillit Bashkiak Kavajë

SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMËRTIMIT TË INSTITUCIONIT NGA "KOPSHTI FIQIRI KURTI" + "MEHMET BABAMUSTA" NË "KOPSHTI DIELL".

Në kuadër të riorganizimit të rrjetit të institucioneve parashkollore në territorin e Bashkisë dhe pas bashkimit të strukturave ekzistuese përkatëse, është konstatuar se në territorin e Bashkisë ekzistojnë disa institucione arsimore dhe parashkollore me emërtime të njëjta ose të përafërta, si më poshtë:

- Shkolla 9-vjeçare "Fiqiri Kurti";
- Kopshti "Fiqiri Kurti";
- Kopshti "Fiqiri Kurti" pranë shkollës 9-vjeçare "Fiqiri Kurti";
- Shkolla 9-vjeçare "Mehmet Babamusta";
- Kopshti "Mehmet Babamusta";

Mbivendosja e emërtimeve ka sjellë në praktikë vështirësi në identifikimin institucional dhe administrativ të subjekteve arsimore, si dhe ka krijuar paqartësi për prindërit, qytetarët dhe institucionet bashkëpunuese.

Ndryshimi i emërtimit të institucionit konsiderohet një masë e nevojshme administrative dhe funksionale:

1. **Për eliminimin e mbivendosjes së emërtimeve institucionale** në kuadër të rrjetit vendor të institucioneve arsimore dhe parashkollore;
2. **Për garantimin e identifikimit unik dhe të dallueshëm institucional** në dokumentacionin administrativ, komunikimin zyrtar dhe raportimin ndërinstitucional;
3. **Për konsolidimin e identitetit administrativ dhe organizativ të institucionit**, në përputhje me konfigurimin aktual të strukturës dhe funksionimit të tij;
4. **Për përmirësimin e eficiencës administrative** në menaxhimin e praktikave, evidencave dhe procedurave të lidhura me funksionimin e institucionit;
5. **Për përshtatjen e emërtimit me karakterin pedagogjik dhe funksionin edukativ të institucionit parashkollor**, duke reflektuar natyrën formuese dhe zhvillimore të këtij shërbimi publik.

Ky projekt–propozim është iniciuar dhe mbështetur nga:

- Bordi i Institucionit;
- Drejtoria e Kopshtit;
- Stafi edukativ;
- Prindërit e fëmijëve që frekuentojnë institucionin.

Zbatimi i këtij projekt–propozimi nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e Bashkisë, përveç kostove administrative minimale për përditësimin e dokumentacionit dhe elementeve identifikuese të institucionit.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak të shqyrtojë dhe të miratojë ndryshimin e emërtimit të institucionit parashkollor:

Nga: "Kopshti Fiqiri Kurti"+ "Mehmet Babamusta"

Në: "Kopshti Diell"

BORDI I PRINDËRVE

1. Hatije Veizi – Kryetar
2. Anila Merhori – Sekretare
3. Rabihane Damarja – Anëtare
4. Juliana Garizi – Anëtare
5. Ornela Disho – Anëtare
6. Ana Jusufi - Anëtare

Drejtori i kopshtit
Lejla GJUZI

Drejtoria Arsimit Parashkollor Parauniversitar
dhe Qendrat Kulturore

Edmond ÇURUMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
"AGJENCIA E ARSIMIT PARASHKOLLOR DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TE ARSIMIT PARASHKOLLOR, PARAUNIVERSITAR DHE QENDRA KULTURORE"

Nr._____ Kavajë, më___.___.2026

RELACION ARGUMENTUES

Për ndryshimin e emërtimit të kopshtit "Fiqiri Kurti + Mehmet Babamusta" dhe emërtimin e këtij kopshti në "Kopshti Diell"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Kavajë

Në vijim të vendimit të Këshillit Bashkiak për riorganizimin e institucioneve arsimore parashkollore dhe bashkimin e kopshteve përkatëse, si dhe mbështetur në kërkesën e paraqitur nga Bordi i Institucionit, stafi edukativ dhe prindërit e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin në fjalë, paraqitet ky relacion argumentues për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimit të emërtimit të institucionit nga **"Kopshti Fiqiri Kurti"** në **"Kopshti Diell"**.

Arsyet dhe argumentet që mbështesin kërkesën për ndryshim të emërtimit:

1. Shmangia e përsëritjes dhe konfuzionit institucional në emërtim
Aktualisht, në territorin e Bashkisë ekzistojnë disa institucione arsimore dhe parashkollore që mbajnë emërtime të njëjta ose të përafërta, konkretisht:

- Shkolla 9-vjeçare "Fiqiri Kurti";
- Kopshti "Fiqiri Kurti";
- Kopshti "Fiqiri Kurti" pranë shkollës 9-vjeçare "Fiqiri Kurti";
- Shkolla 9-vjeçare "Mehmet Babamusta";
- Kopshti "Mehmet Babamusta";

Kjo situatë krijon paqartësi dhe konfuzion në identifikimin administrativ dhe praktik të institucioneve, si për qytetarët dhe prindërit, ashtu edhe për strukturat administrative, institucionet arsimore dhe shërbimet publike.

2. Nevoja për identitet të veçantë institucional
Pas riorganizimit dhe bashkimit të strukturave ekzistuese, institucioni i ri i krijuar duhet të ketë një identitet të dallueshëm dhe autonom, që ta veçojë qartë nga institucionet e tjera arsimore në territorin e Bashkisë. Një emërtim i ri do të ndihmojë në krijimin e një profili të veçantë institucional dhe në konsolidimin e identitetit të vet organizativ e pedagogjik.

3. Përshtatshmëria pedagogjike dhe edukative e emërtimit të propozuar
Emërtimi i propozuar **"Kopshti Diell"** përfaqëson një simbolikë pozitive, të ngrohtë dhe edukative, e lidhur natyrshëm me zhvillimin, rritjen, energjinë dhe mirëqenien e fëmijëve në moshën parashkollore. Ky emërtim përputhet me natyrën dhe misionin e institucionit si hapësirë edukimi, zhvillimi dhe përkujdesjeje për fëmijët.

4. Mbështetja e komunitetit të institucionit
Propozimi për ndryshimin e emërtimit është bërë dhe mbështetet nga:

- Bordi i Institucionit;
- Drejtoria e kopshtit;
- Stafi edukativ;
- Prindërit e fëmijëve që frekuentojnë institucionin.

Ky fakt dëshmon se kërkesa përfaqëson një vullnet të gjerë dhe të konsoliduar të komunitetit të institucionit.

5. Përmirësimi i administrimit dhe komunikimit institucional
Një emërtim i veçantë lehtëson ndjeshëm procedurat administrative, dokumentacionin zyrtar, komunikimin ndërinstitucional dhe orientimin e qytetarëve në raport me institucionin.

Në kushtet kur ndryshimi i propozuar:

- shmang përsëritjen dhe konfuzionin në emërtimet ekzistuese;
- krijon identitet të ri institucional;
- gëzon mbështetjen e komunitetit të institucionit;
- dhe përmirëson administrimin e institucionit;

kërkohet nga Këshilli Bashkiak miratimi i ndryshimit të emërtimit të institucionit nga "Kopshti Fiqiri Kurti" në "Kopshti Diell".

DREJTORI

EDMOND ÇURUMI